



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

---

Numri i lëndës: 2019:262921

Datë: 22.02.2023

Numri i dokumentit: 04004037

A.nr.1029/17

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtarin Kreshnik Kaçiu dhe zyrtaren ligjore Shqipe Jashari, në konfliktin administrativ të paditësit M. D. nga fsh.V., K.K.P., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson V. A., avokat nga Gj. kundër të paditurës Komuna e Pejës, Kuvendi Komunal – Departamenti për çështje juridike pronësore, për shkak të anulimit të vendimit nr.463-01-54290 të datës 28.04.2017, pas shqyrtimit kryesor publik, me datë 07.02.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pabazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit M. D. nga V., K.K.P., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson V. A., avokat nga Gj., me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi nr.463-01-54290 i datës 28.04.2017 i Kuvendit Komunal Pejë.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike, u mbajt konform nenit 41 të LKA-së, me praninë e palës paditëse e në mungesë të palës së paditur të ftuar në mënyrë të rregullt.

Paditësi me padinë e datës 20.06.2017, kërkon nga Gjykata anulimin e vendimit përfundimtar të të paditurës si dhe vendimeve përkatëse të nxjerra nga e paditura Komuna e Pejës. Pohon së më vendimin e nxjerrë nga Komuna e Pejës i ishte refuzuar kërkesa për dhënie të tokës në shfrytëzim ish.K.K.Pejë, nr.463/134-4, të datës 04.06.1996 e cila ishte caktuar në emër të D. M. në parcelën kadastrale 790/2 në sipërfaqe prej 0.11.32 ha, ZK Vitomicë, e që ndaj të njëjtës kishte ushtruar ankesë tek e paditura. Shton se e paditura pa shqyrtuar fare dokumentet, në mënyrë paushalle refuzon ankesën si të pabazuar. Po ashtu paditësit i është cenuar e drejta e pronës në parcelën kadastrale nr.790/2 meqë këtë të drejtë e ka fituar në mënyrë ligjore. Paditësi po ashtu deklaroi së duke u bazuar në këtë të drejtë të vërtetuar për pronën paditësi bazuar në Ligjin nr.220/05 dhe

Ligjit 220/13, është regjistruar nga AKK si pronar dhe për këtë posedon dëshmitë, vendimin nr.03946/10-03/11 68/10, dt.02.10.2010 dhe vendimin e Komunës së Pejës më nr.01/469-09, dt.24.04.2011. I propozon Gjykatës që padinë ta aprovoj si të bazuar dhe të anuloj vendimet e të paditurës.

Në seancën e shqyrtimit kryesor, përfaqësuesi i paditësit deklaroi: *“Mbesim pranë pretendimeve në padi dhe kërkesëpadi . E kundërshtoj përgjigjen në padi sepse e paditura nuk e dorëzon asnjë material provues e cila do ta kontestonte padinë e paditësit, përgjigje në padi është deklarata dëshirore e të paditurës pa bazë ligjore . Njoftoj gjykatën se në këtë çështje juridike me gjendjen e njëjtë faktike dhe juridike njëherë është vendosur dhe atë me aktgjykim të plotfuqishëm A.nr. 1498/13 nga viti 2017, gjithashtu deklaroj se aktvendimin të cilin e kontestoj me padi të K.K. Pejë, është i jashtëligjor nga fakti se paditësi i është shkelur e drejta e pronës me aktvendimin e lartcekur të kontestuar në parcelën kadastrale nr. 790/2 Z.K. Vitomiricë. Të drejtën e pronësisë paditësi e ka arritur në mënyrë ligjore të cilën e ka vetëtuar edhe HABITAT me aktvendimin nru.HPCC-D-153 /2004/C, dhe bazuar në Ligjin numër 220/05 dhe 220/13 , paditësi është i regjistruar si pronarë në AKK në bazë të aktvendimit 03946/10 -03/11, 68/10 dt. 02.10.2010, Me këtë lloj të gjendjes faktike juridike e paditura K.K. Pejë nuk ka pasur bazë ligjore që t’ia merr pronën paditësi pa kompensim , të drejtën e pronës si e drejtë e pamohueshme e garantuar me Kushtetutën e Kosovës dhe konventën evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut , është e pamohueshme dhe mundtë merret vetëm me interesin e përgjithshëm me obligimin e kompensimit adekuat, e në rastin konkret K.K. Pejë duke i shkelur të gjitha ligjtë e lartcekura merr një aktvendim të kontestuar dhe duke i shkelur dispozitat e ligjit të kësaj procedure të nenit 1,5,66,90,118 deri me 126, si dhe rregulloren e UNMI-ut 200/60 neni 20 paragrafi 2.5, 2.6 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 206/50, neni 11 paragrafi 116/8 dhe neni 20. Gjykatës i propozojmë që ta anuloi vendimin e Komunës së Pejës numër 463-01-54290 dt. 28.04.2017 dhe numër 18-2017 nga dt. 27.04.2017, dhe të urdhëroi Agjencinë Kadastrale të Kosovës, Zyrën Komunale të Kadastrit në Pejë, që ta dorëzoi gjendjen e regjistrimit duke u bazuar në aktvendimin të cilin e kamë dorëzuar me padi, e kjo është gjendja e vitit 2013, si dhe të obligoi të paditurën që paditësit t’ia kompensoi shpenzimet e procedurës në bazë të TA-së”.*

Ndërkaq në fjalën përfundimtare deklaroi: *“Procedura e leximit të provave pa dyshime vërteton faktin që padia e paditësit është e bazuar ndërsa aktvendimi i të paditurës është i paligjshëm dhe se gjykata e ka situatën e qartë se e paditura me marrjen e aktvendimit të përsëritur ka shkaktuar shkelje materiale dhe procedurale dhe jashtëligjshëm ia ka marr pronën paditësit pa konkluzim , andaj gjykatës i propozojmë që në tërësi të aprovoi kërkesëpadinë ashtu siç është definuar në petitumin e padisë”.*

E paditura Komna e Pejës, me përgjigjen në padi të datës 17.07.2019 e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, të parregullt dhe e pakuptueshme sepse është në kundërshtim më nenin 16 par.1 i Ligjit për Konfliktet Administrative, ngase nuk përbën asnjë nga shkaqet për të cilat mund të kundërshtohet më padi një akt administrativ. Padia po ashtu është edhe në kundërshtim më nenin 16 par.2 të LKA-së, e cila parasheh që *‘Akti administrativ nuk mund të kundërshtohet për aplikim jo të drejtë të dispozitave, kur organi kompetent ka vendosur sipas vlerësimit të lirë në bazë të autorizimeve dhe në kuadrin e kufijve që i janë dhënë më dispozitat ligjore, në pajtim më qëllimin për të cilin i është dhënë autorizimi’.* Nga shkaqet e lartcekura, por edhe nga shkaqet tjera juridike dhe faktike padia e paditësit është pa mbështetje ligjore, juridike dhe si e tillë duhet të refuzohet në tërësi nga Gjykata. Po ashtu gjykata thekson së vendimi i nxjerrë jo për interes të përgjithshëm por për qëllime të themelimit të kolonive ana ana e pushtuesit serb, vendimi është nxjerrë pa zbatim të procedurave ligjore, në regjistrat e të

paditurit të vitit 1966 kur pretendohet nga paditësi së është nxjerrë aktvendimi i lartcekur, nuk është gjetur ndonjë dokumentacion se është zhvilluar procedurë e ndarjes së asaj parcele, ky aktvendim është i paligjshëm, i falsifikuar, në rendin e kësaj seance të datës 04.06.1996 nuk ka qenë ndarja e trollit të tillë paditësit, bashkësia territoriale e fsh. Vitomiricë, nuk ka pasur kompetencë të zhvilloj një procedurë për ndarjen e trulloit në pronësi shoqërore të komunës, sepse kjo do të ishte në kundërshtim në ligjet e zbatueshme në vitet e 90-ta. I propozon Gjykatës që ta refuzoj padinë dhe kërkesëpadinë si të pabazuar dhe të vërtetoj vendimin e Komunës së Pejës.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata ka bërë administrimin e provave dhe atë: Aktgjykimi i kësaj gjykate A.nr.1498/13, dt. 10.03.2017, vendimi i K.K. Pejë me numër 463/01-54290 dhe numër 18/2017 i dt. 28.04.2017, vendimi numër 02.nr.463/134-4 i dt. 04.09.1996.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, dhe gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

Gjykata gjeti se Vendimi përfundimtar i kontestuar i cili është marrë nga ana e të paditurës, është marrë konform të gjitha dispozitave procedurale dhe ligjore në fuqi dhe se i njëjti në asnjë rrethanë nuk përmban as shkelje esenciale të dispozitave procedurale, as vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike e as zbatim të gabueshëm të së drejtës materiale.

Sa i përket vendimit përfundimtar të marrë nga e paditura, gjykata gjeti se e paditura ka marrë vendim në përputhje me ankesën e paditësit dhe vendimi i Komunës së Pejës përmban dhe përmbushë të gjitha kushtet dhe elementet ligjore të parapara me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Në këtë drejtim, Gjykata gjeti se paditësi as me padi dhe as në seancën e shqyrtimit kryesor, nuk paraqiti prova të mjaftueshme për ti mbështetur pohimet e tij të cilat do të dëshmonin se me vendimin kontestues të të paditurës i është shkelur ndonjë e drejtë e përcaktuar me ligj.

Gjykata i mbështeti si plotësisht të drejta dhe të ligjshme arsyet mbi bazën e të cilave është marrë vendimi i kundërshtuar dhe në këtë drejtim përkrahi arsyetimin e të paditurës të dhënë në arsyetimin e vendimit të kundërshtuar se e refuzon ankesën e palës si të pabazuar duke u mbështetur në Vendimin përfundimtar të Kuvendit Komunal në Pejë nr.436-820 të datës 31.01.2012, departamenti për çështje juridiko-pronësore ka qenë i detyruar që në bashkëpunim më avokatin publik komunal dhe drejtorin e departamentit për Katastër dhe gjeodezi bëjnë përgatitjen e informatës në lidhje me dhënien jo ligjore të pronave komunale nga ana e organeve të atëhershme komunale në periudhën prej vitit 1990-99, për shfrytëzimin e këtyre vendimeve përfundimtare më qëllim të kthimit të pronave të tjetërsuara komunale në mënyrë jo-ligjore, pronarit legjitim të komunës së Pejës.

Mbi këtë bazë, gjykata i pranoi si të ligjshëm dhe të drejtë refuzimin e të paditurës ndaj ankesës së palës dhe në lidhje me këtë, gjykata gjeti se e paditura ka zbatuar siç duhet ligjin material,

drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe ka vendosur në tërësi konform nenit 132 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, duke u bazuar në këto prova dhe në dispozitat e sipërcituara, gjykata vlerëson se vendimi i goditur me padi është i drejtë dhe i bazuar në gjendjen e vërtetuar faktike.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të paditësit, por të njejtat i vlerësoi si të pa bazuara, ngase të njejtat nuk i ka provuar me asnjë provë të vetme, as para të paditurës e as me padinë e ushtruar në këtë Gjykatë.

Prandaj gjykata përfundimisht konstatoi se në këtë çështje administrative, drejtë është vërtetuar gjendja faktike, e paditura drejtë ka zbatuar dispozitat e procedurës administrative dhe të ligjit material, kur ka marrë vendimin e kontestuar nga paditësi. Mbi këto arsye thëniet e paditësit në padi nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike, nga ajo e vërtetuar nga e paditura.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46, paragrafit 2, lidhur me nenin 5, 6 dhe 38 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË  
Departamenti për Çështje Administrative  
A.nr.1029/17, datë; 07.02.2023

G j y q t a r i

---

Kreshnik Kaçiu

Këshillë Juridike: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.